

## PALOK DAKA

VËZHGIME MBI EMRA VETJAKE TË ARDHUR NGA LEKSIKU  
I PËRGJITHSHËM I SHQIPES

Ndryshimet e mëdha social-ekonomike e ideo-kulturale të këtyre njëzetepesë vjetve të fundit në vendin tonë, që kanë ardhur si rezultat i fitores së revolucionit popullor dhe i thellimit të mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kultural, kanë përmbysur e po përmbysin dita-ditës edhe mjaft norma, zakone, koncepte e mbeturina të tjera të së kaluarës, që janë të huaja e të papajtueshme me realitetin tonë të sotëm, duke u zëvendësuar me norma, zakone e koncepte të reja, socialiste, të epokës sonë. Në kuadrin e këtyre ndryshimeve janë përfshirë e po përfshihen edhe emrat e njerëzve, si një kërkesë objektive e zhvillimit të shoqërisë sonë të re.

Si shumë shfaqje dhe fenomene të ndryshme të jetës shoqërore, edhe emrat e njerëzve kanë qenë dhe janë tregues të zhvillimit të shoqërisë, të kulturës dhe të mendimit njerëzor nga një etapë a epokë e historisë së njerëzimit në tjetrën. Edhe ata i nënshtrohen ligjit dialektik të zhvillimit: lindin, zhvillohen, ndryshohen dhe zhduken në këtë apo atë etapë të caktuar të zhvillimit të gjuhës dhe të shoqërisë. Këtej del se njohja dhe studimi i emrave të njerëzve, i prejardhjes dhe i historisë së tyre janë të lidhura ngushtë me historinë e gjuhës dhe të kulturës materiale e shpirtërore të popullit. Çdo epokë apo kthesë e shënuar, progresive ose regresive, në historinë e një populli është shoqëruar gjithnjë me një varg ndryshimesh dhe fenomenesh të reja si në lëmin e zhvillimit ekonomik-politiko-shoqëror ashtu edhe në atë ideologjiko-kultural. Këto ndryshime kanë ndikuar, në masë e në kohë të ndryshme, edhe në sferën e emrave të njerëzve (në lindjen, përdorimin, përhapjen apo edhe në zhdukjen e tyre). Kështu p.sh. ekzistenca tek ne e emrave vetjakë, laikë e fetarë, me prejardhje të huaj (greke, romake, bizantino-sllave, arabo-perso-turke etj.), krahas emrave të fondit vendas, është e lidhur ngushtë edhe me rrethanat dhe ngjarjet e mëdha historike e kulturale nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë gjatë shekujve.

Nga gjuhëtarë e studjues të ndryshëm është shprehur dhe pranuar mendimi se emrat e njerëzve të të gjithë popujve, si emra të përveçëm, janë sajuar kryesisht nga fjalë, fraza a shprehje të zakonshme të gjuhës, d.m.th. ata burojnë nga njësi të sferave të ndryshme të leksikut të gjuhës së vendit përkatës, ose nga njësi të sferave të ndryshme të leksikut

të gjuhëve të vendeve të tjera, të huazuar, kryesisht, si antroponime. Një fenomen i tillë vihet re edhe tek emrat tanë vetjakë<sup>1</sup>.

Sipas prejardhjes së tyre, emrat vetjakë të sotëm të shqipes ndahen në dy grupe kryesore:

1. Në grupin e parë hyjnë emrat vetjakë vendas dhe kryesisht: a) emrat vetjakë të shtresës ilire, të cilët, megjithëse shumica e tyre nuk mund të shpjegohet (ose nuk është shpjeguar ende) me mjetet gjuhësore të shqipes së sotme, përbëjnë fondin më të lashtë antroponimik vendas; b) emrat vetjakë të burimit shqip, që shpjegohen me anë të njërive të ndryshme të leksikut të sotëm të shqipes, me emra të përgjithshëm ose kategori të tjera leksiko-gramatikore, togje a grupe fjalësh të sferave të ndryshme të leksikut konkret e abstrakt (të botës sendore, shtazore, bimore, nga toponomastika etj.); c) emrat vetjakë të burimit shqip, por që janë cunçuar prej kohësh dhe që nuk u dihet prototipi, ose emrat e sajuar artificialisht me kombinime inicialesh, anagramesh a çpikje të rastit etj.

2. Në grupin e dytë hyjnë gjithë emrat e burimit të huaj (fetarë ose laikë)<sup>2</sup>.

Si gjithë popujt e tjerë të lashtë, edhe të parët tanë, ilirët, kanë patur fondin e tyre të emrave vetjakë të burimit vendas. Për fat të keq, ashtu siç humbën në errësirën e shekujve shumë elemente dhe vlera të kulturës materiale e shpirtërore të stërgjyshërve tanë, ashtu humbën edhe shumica e emrave vetjakë të atyre kohëve. Kjo gjendje shpjegohet, ashtu si edhe për shumë popuj e vende të tjera të botës, jo vetëm nga përmbysjet dhe shndërrimet e mëdha të së kaluarës, po edhe nga mungesa e burimeve shkrimore a të mbishkrimeve ilire dhe të treguesve të tjerë të kësaj sfere ende të panjohur e të pazbuluar. Shumë emra vetjakë të lashtësisë u varrosën bashkë me bartësit e tyre, pa u fiksuar

1) Kështu p.sh. emrat shqip si *Agim, Pranverë, Dritë, Kujtim, Shpresë, Lule, Bardh, Shegë* etj. kanë ardhur drejtpërdrejt nga leksiku i shqipes (agim, pranverë, dritë, kujtim, shpresë, lule, bardh, shegë etj.), ndërsa emrat e huaj (është fjala për ata që përdoren edhe tek ne dhe për të cilët shqiptari pak ka qenë i interesuar të dijë se ç'kuptim kanë në gjuhët nga janë marrë) janë huazime të kohëve të ndryshme. Ashtu siç shpjegohen emrat vendas me anë të gjuhës shqipe, ashtu shpjegohen edhe shumica e emrave të huaj me anë të gjuhëve nga kanë dalë. Kështu p.sh. emri *Gjergj* vjen nga gr. *georgos*, që do të thotë «bujk» ose «ai që punon tokën», emri *Sofi* vjen nga gr. *sofi* që do të thotë «dituri», emri *Irenë* vjen nga gr. *eiréne*, që do të thotë «paqë», emri *Viktor* vjen nga lat. *victor*, që do të thotë «fitimtar», emri *Mustafa* vjen nga arab. *mustafa*, që do të thotë «i zgjedhur», emri *Nuredin* vjen nga arab. *nur-e-din*, që do të thotë «shkëlqim i fesë», emri *Robert* vjen nga gjer. *hrod e berht*, që do të thotë «shkëlqim i lavdisë», emri *Rikard* vjen nga gjer. *rich e hard*, që do të thotë «trim i fuqishëm» etj. Për prejardhjen e tyre, e të tjerë, shih edhe: A. Dauzat, *Les noms de Personnes — origine et évolution*, Paris 1928 dhe: *Traité d'anthroponymie française*, Paris 1949; A. Graur, *Nume de Persoane*, București 1966; S. Ilçev, *Reçnik na ličnité i familni imena u bëllgarite*, Sofje 1969; N. A. Petrovskij, *Slovar russkih ličnijh imen*, Moskva 1966; P. Daka, *Antroponimia ose emrat e njerëzve në gjuhën tonë*, «Vatra e Kulturës», 1969, 1, f. 33.

2) Në grupin e emrave të huaj hyjnë emrat vetjakë, shumica të asimiluar, të periudhës romake e greko-bizantino-sllave, të cilët përbëjnë kryesisht shtresën e vjetër të emrave fetarë të besimit katolik e ortodoks si dhe emrat arabo-persoturke që përbëjnë kryesisht shtresën e emrave fetarë të besimit mysliman. Veç këtyre, kemi edhe një shtresë emrash të huaj, laikë, të ashtuquajtur modernë, nga burime të ndryshme (letrare, artistike, politike, shoqërore, kulturalë etj.), që janë përdorur e përdoren edhe sot nga mbajtës vendas, pavarësisht nga besimi që kanë ose kanë patur. Meqenëse ky grup përbën objektin e një punimi të gjerë, më vete, trajtimi i emrave me origjinë të huaj u la jashtë këtij punimi.

në asnjë shkrim; të tjerë, që patën fatin të fiksoheshin në ndonjë shkrim të mëvonshëm, u zhdukën bashkë me aktin që i përmbante, kurse një pakicë fare e vogël, që u ruajt në shkrime a mbishkrime të ndryshme, mundi të arrinte në ditët tona. Këta të fundit përbëjnë atë fond emrash ilirë që njihen në kohën tonë, të cilët, siç dihet, u përkasin kryesisht atyre brezave që jetuan gjatë shekujve të kolonizimit grek e të pushtimit romak<sup>3</sup>. Nuk ka asnjë dyshim se shumica e emrave vetjakë ilirë të njohur (është fjala për ata të burimit shkrimor të periudhës greko-romake) janë emra të trashëguar që nga koha e fiseve të lashta ilire. Ndonjë prej tyre mund të jetë sajuar nën ndikimin e ndonjë emri grek apo romak të kohës, apo edhe si huazim i drejtpërdrejtë, ashtu sikurse mund të supozohet që ndonjë emër grek apo romak i asaj kohe të jetë sajuar nën ndikimin e ndonjë emri ilir të kohës, apo si huazim ilir. Historia njuh mjaft raste ndikimesh e huazimesh të shumëllojshme, si në shumë sfera të tjera, edhe në atë të emrave vetjakë. Kështu p.sh. disa të dhëna të onomastikës ilire (emra vetjakë, patronime, etnonime e toponime), të hetuar në truallin shqiptar, si *Melisa*, *Mentori* e ndonjë tjetër (dhe që janë në qarkullim si emra vetjakë edhe në ditët tona) janë të njohur edhe përtej kufijve të botës iliro-shqiptare. Këtu mund të jetë fjala ose për huazime të drejtpërdrejta nga njëra gjuhë në tjetrën, ose për përputhje fonetike. Këto të fundit, si në leksik ashtu edhe në onomastikë, janë një fenomen i njohur. Më se një herë janë vënë re emra ose fjalë me përbërje tingullore të njëjtë që ndeshen njëkohësisht në dy a më shumë gjuhë të ndryshme, pa asnjë lidhje a ndikim të këtyre emrave a fjalëve njëri me tjetrin.

Në fushën e studimit të onomastikës ilire, siç dihet, janë bërë herë pas herë një varg përparimesh me interes<sup>4</sup>; megjithatë, mbetet ende shumë punë për t'u bërë, veçanërisht në fazën e tanishme, kur numri i emrave të rinj ilirë, që po zbulohen, vjen gjithnjë duke u rritur.

Në këtë punim, vëzhgimet tona do të përqëndrohen, në vija të përgjithshme, kryesisht tek shtresa e emrave vetjakë, që vinë nga leksiku i përgjithshëm i shqipes.

Populli ynë, si në çdo sferë tjetër të jetës e të kulturës së tij, edhe në atë të emrave vetjakë, ka krijuar e ruajtur, edhe si kundërveprim ndaj emrave fetarë e të huaj negativë, gjatë gjithë kohëve fondin e tij të emrave vetjakë, laikë e kombëtarë. Mjerisht, duhet

3) Dihet se emrat ilirë, të njohur në kohën tonë, vinë nga burime të ndryshme të shkruara në gjuhët greke a latine dhe kryesisht: a) nga vepra autorësh klasikë greko-romakë, b) nga numizmatika (monedhat e lashta) dhe c) nga mbishkrimet e zbuluara nëpër nekropolet e ndryshme të vendit tonë. Më gjerë për fondin e shkruar të emrave ilirë mund të shihen edhe: H. Krahe, *Lexikon altillyrischen Personnamen*, Heidelberg 1929; A. Mayer, *Die Sprache der alten Illyrier*, Band I: *Einleitung Wörterbuch der illyrischen Sprachreste*, Wien 1957; V. Toçi, *Mbishkrime e relieve nga nekropoli i Dyrrahit*, «Bulet. USHT. Shk. Shoq.», 2, 1962, f. 70-132; Po ay, *Të dhëna mbi onomastikën ilire në Dyrrah dhe qendra të tjera të vendit tonë*, «Stud. fil.», 3, 1969, f. 169-189; H. Ceka, *Përputhje onomastike ilire-epirote*, «Stud. hist.», 2, 1965, f. 85-92; I. I. Russu, *Illiri historia — Limba și onomastica*, București, 1969.

4) Shih edhe: H. Krahe, *vep. cit.*; A. Mayer, *vep. cit.*; I. Russu, *vep. cit.*; V. Toçi, *vep. cit.*

thënë, kërkime e studime të kënaqshme në këtë fushë sot për sot mungojnë. Ato sapo kanë filluar. Kështu që pak të dhëna kemi në dorë për historinë, kronologjinë, zhvillimin dhe përhapjen e emrave vetjakë të burimit shqip. Nga kërkimet e bëra për emrat vetjakë të burimit shqip, del se një nga emrat më të lashtë, që ka vazhduar të përdoret në popull për disa shekuj me radhë, është emri vetjak *Ujkan*. Ky emër, sipas një artikulli të botuar më 1929<sup>5</sup>, na del të jetë i përdorur që në shek. XII. Megjithëse ky burim nuk është dokument autentik i shek. XII (prandaj e japim me rezervë), ekzistenca e emrit vetjak *Ujkan* (ose *Ujk* apo *Ulk*) në këtë kohë, e mbase edhe më përpara, na duket i mundshëm. Ky pohim gjen mbështetje edhe në këto argumente: a) fjala *ujk*, siç dihet, është e njohur dhe bën pjesë në grupin e fjalëve me të lashta indoevropiane të shqipes; si e tillë kjo fjalë ka ekzistuar (në këtë apo në një variant tjetër fonetik) shumë më përpara se sa në shek. XII; b) se këtë fjalë, si fjalë e vjetër e shqipes, e ndeshim edhe në toponiminë e lashtë (khs. top. ilir. *Ulcinium* — Ulqini i sotëm), c) se këtë fjalë, si emër vetjak, në variantin *Ulk*, e ndeshim edhe në një burim të shek. XV, në «Defterin e Shkodrës të vitit 1485» (shih shën. 15), gjë që dëshmon për vazhdimësinë e përdorimit të këtij emri, ç) se edhe në ditët tona ky emër është i gjallë dhe njihet veçanërisht në disa krahina malore të Shqipërisë së veriut, si emër i vjetër i burimit popullor, krahas me variantet *Ujkan*, *Ulk*, *Ukë*, *Uk* e *Ukshin*, pa përmendur edhe variantet e huazuara, d) më në fund, përdorimi i fjalës *ujk*, si emër vetjak (së pari si simbol i forcës ose edhe i ndonjë paragjykimi tjetër tek popujt e lashtë, p.sh. kundër së keqes etj.) është i njohur jo vetëm tek ne, po edhe ndër vende të tjera fqinjë e jo fqinjë (khs. p.sh. emrat vetjakë tradicionalë në sll. *Vuk* ose bulg. *Vëllko*, rum. *Lupu*, gjer. *Wolf*, tur. *Kurt* etj. emra këta që i korespondojnë në shqipe fjalës *ujk*).

Që nga shek. XIV e këtej, sipas të dhënave që kemi, numri i emrave të burimit shqip të dokumentuar vjen gjithnjë duke u rritur. Kështu p.sh. në një burim të shek. XIV ndeshim emrin vetjak *Bardhi*<sup>6</sup>, në trajtën *Bardus*, në këtë kontekst «[viti 1321]. Propterea cum chefalia nepotem summ presbyterem Stephanus et familiarem summ *Bardum* (nënvizimi imi — P.D.) mittit»<sup>7</sup>.

Gjithnjë sipas disa burimeve dokumentare, emrat vetjakë të burimit shqip dëshmojnë, veçanërisht në shek. XV, edhe në një sërë aktesh e dokumentash të tjerë. Kështu p.sh. në «Catasto Veneto di Scutari (1416-1417)», emrin vetjak *Bardhi*, nën trajtën *Bardi*, e ndeshim tri herë «*Bardi Bisessa*, *Bardi Sigeci*, *Bardi Strelj*»<sup>8</sup>, kurse në një burim tjetër të vitit 1431 emrin vetjak *Bardhi* e ndeshim përsëri në trajtën *Barda*,

5) Në një shkrim të F. Cordignanos, botuar në *Civiltà Cattolica*, Roma 1929, f. 403, gjendet ky kontekst: «per intercessione di Uikan, principe di Dioclea nel 1199, Antivari riuscì ad ottenere da Innocenzo III il pallio arcivescovile».

6) Të dhënat jepen vetëm për emrat vetjakë (të parmë) dhe jo edhe për mbiemrat e patronimet, të cilët, në disa raste, dëshmojnë edhe më herët dhe si numër janë më të shumtë. Këta të dytët mbeten për t'u trajtuar në një punim më vete mbi patronimet në shqipen.

7) L. Thallóczy, C. Jireček et E. Šufflay, *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vol. II, Zagreb 1913, f. 203.

8) F. Cordignano, *Catasto Veneto di Scutari e Registrum Concessionum*, 1416-1417, vol. I, Shkodër, 1940, f. 116, 120-121.

«Timar-i Barda...»<sup>9</sup>. Edhe në «Defterin e Dibrës të vitit 1467» po këtë emër në trajtën *Bard-i*, e ndeshim disa herësh «Bard Bullaçi, Bard Buzuzija, Bard Bosini etj.»<sup>10</sup>. Tek shqiptarët e Peloponezit të shek. XV, veç emrit Bardhi, të cilin e ndeshim disa herë «Bardhi Shalsi, Bardhi Zoga, Bardhi Capuga, Bardhi Pete, Bardhi Gurzumsha, Bardhi Zola etj.»<sup>11</sup>, vërejmë edhe emra të tjerë si p.sh. *Kuqe* («e veja Kuqe, grua e Badhenës»), *Trim* («Trim Zhonbete»), *Mirash*<sup>12</sup> (nga: Mir+ash) («Engjello Buzos... Mirash vëllai i tij»)<sup>13</sup>, *Buz* («Buz Bardhi»)<sup>14</sup>, *Ulk* («Ulku i biri...»)<sup>15</sup> dhe emra të tjerë si *Diellë*, *Rrap*, *Lal*, *Trim*, *Lalush*, *Bardhec* etj.<sup>16</sup>

Veç emrave të thjeshtë, që u përmendën më lart, në dokumentat e kësaj periudhe ndeshen edhe disa emra të përbërë. Kështu p.sh. në «Catasto Veneto» ndeshim emrin e përbërë *Dassimirj*<sup>17</sup>, të cilin M. Domi, jo pa rezervë, e lidh me emrin e sotëm *Dashamir-i*<sup>18</sup>. Edhe dy emra të tjerë të përbërë janë *Fatmir*, që ndeshet në «Defterin e vitit 1431» për Tomorricën («Timar Barda... veled-i Fatmir<sup>19</sup> = Timari i Bardhit... i biri Fatmirit»)<sup>20</sup> dhe *Lisimadh* («Nikolla i biri i Lisimadit») që ndeshet te «Defteri i Dibrës 1467»<sup>21</sup>. Në një burim të shek. XVII ndeshen edhe të tjerë emra vetjakë shqip si p.sh. *Ball* («Ball Gjika, Ball Gjuma, Balli Mare, Ball Koçi, Ball Koca»), *Bark* («Bark Gjika, Bark Gjone»), *Gur* («Gur Kasur»), *Mal* («Mal Gjika»), *Mash*<sup>22</sup> («Mash Pjetri»)<sup>23</sup> etj.

Këta janë, sipas disa burimeve dokumentare, një pjesë e emrave vetjakë të burimit shqip, që ndeshen në shekujt XII-XIV-XV-XVII. S'ka dyshim se me botimin e dokumentave, akteve, kronikave, relacioneve dhe regjistrave të tjerë të së kaluarës si dhe me vjeljen sistematike

9) *Hicri 835 Tarihi-Suret-i Defter-i Arvanidi* metni bir giris ile nesreden Halil Inalçik, Ankara 1954, f. 76.

10) «Defteri emëror i Vilajetit të Dibrës, Dulgoberdës, Rjekës, Çermenikës dhe të tjera, 1467» (Përkth. shqip në drsh. në Arkivin e Inst. hist. e gjuh. Dosja A. III. 315).

11) R. Stojkov — Th. Kacori, *Një regjistër osmano-turk i shek. XV për Shqiptarët e Peloponezit* në «Stud. hist.», 3, 1966, f. 155, 157, 162.

12) Emrin vetjak *Mirash* e ndeshim edhe në «Defterin e Përmetit e të Korçës — vilajeti i Korçës — 1432» në kontekstin «Gjini i biri i Mirashit». (Përkth. shqip në drsh. në Arkivin e Inst. Hist. gjuh. Dosja A. III. 323). Emri *Mirash* në kohën tonë njihet vetëm në disa fshatra të Malsisë së Veriut, por prania e tij në rrethin e Korçës dhe te shqiptarët e Peloponezit në shek. XV, paraqet një interes të veçantë.

13) R. Stojkov — Th. Kacori, *vep. e cit.*, f. 155, 157, 159.

14) *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV — Burime osmane — përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha*. Tiranë, 1968, f. 348.

15) «Defteri i Shkodrës 1485» — (Cituar sipas M. Domit, *Burime dhe materiale të shqipes së shekullit XV*, në «Stud. fil.», 3, 1968, f. 76.

16) R. Stojkov, *Odin neizvestnij istočnik albanskoj onomastiki seredini XV v. «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes»*, T. III (histoire), Sofia, 1969, f. 552.

17) F. Cordignano, *Catasto Veneto...*, f. 82.

18) M. Domi, *Burime dhe materiale...* f. 79.

19) H. Inalçik, *vep. e cit.* f. 76.

20) Shih edhe A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, «Bulet. USHT, Shk. Shoq.» 3, 1961, f. 4.

21) *Defteri i Dibrës 1467*, (Përkth. shqip në drsh. Arkivi i Inst. hist. gjuh. Dosja A. III. 315 (shih shën. 10).

22) *Mash* është shkurtim i *Marash* dhe vjen nga mbiemri «i m(b)arë» khs. edhe fem. *Marë-a*.

23) Th. Kacori, *Një regjistër osmano-turk i vitit 1642-1643* «Stud. hist.», 3, 1966, f. 172-173.

e shterruese të antroponimisë shqiptare, do të bëhej e mundur dhënja e një pasqyre më të plotë, jo vetëm për kronologjinë dhe evolucionin e emrave vetjakë të shqipes, po edhe për shtrirjen dhe përdorimin e tyre, mjetet e sferat e leksikut të shqipes, që kanë shërbyer, në të kaluarën, si burim emrash vetjakë.

\*

Që nga Rilindja dhe Shpallja e Pavarësisë dhe, veçanërisht, që nga Çlirimi e këtej, numri i fjalëve apo i njësive të gjalla të leksikut të sferave të ndryshme të shqipes, që ka kaluar e po kalon në lëmin e emrave vetjakë, ka ardhur gjithnjë duke u rritur.<sup>24</sup> Kjo prirje e pasurimit dhe e përhapjes në shkallë të gjerë të emrave vetjakë të burimit shqip, që vihet re veçanërisht këto vitet e fundit, shpjegohet, në radhë të parë, nga interesimi dhe dëshira e vetë masave të gjera të popullit për t'i pasur edhe emrat e njerëzve në pajtim me frymën e kohës, me zhvillimin e shoqërisë dhe të kulturës sonë të re pa mohuar, natyrisht, edhe traditat e shëndosha të së kaluarës<sup>25</sup>.

Kuptohet se emrat vetjakë shqip, që janë sot në qarkullim, nuk janë të një periudhe të vetme dhe as të një burimi të vetëm. Disa janë më të vjetër, disa më të rinj. Disa janë të burimit popullor, të tjerë të burimit kultural. Kështu p.sh. të burimit popullor, të nxjerrë kryesisht nga leksiku i sferës së florës dhe të faunës dhe më pak nga leksiku abstrakt, janë emrat *Lule, Rrap, Shegë, Dash, Gjel, Shpend, Sokol, Thëllenzë (Fllanzë), Ujk, Zog, Zogë, Pulë, Borë, Bjeshkë, Diellë, Hënë, Bute, Bardh e Bardhe, Mir e Mirë* etj. si dhe derivatet përkatse *Lulash, Rrapush, Shegan, Gjelosh, Ujkan, Mirosh* etj.

Veç emrave të burim popullor, në fondin e emrave vetjakë të shqipes kanë hyrë, veçanërisht gjatë këtij shekulli, edhe mjaft emra të tjerë, kryesisht me rrugë kalkimi a përkthimi, nga gjuhë të huaja. Me anë të kësaj rruge, na duket, janë krijuar emrat *Betim* (nga: Jemin), *Shpëtim* (nga: Mehdi), *Shkëlqim* (nga: Nuri), *Agim* (nga: Sabah), *Lumturi* (nga: Sadete), *Besnik* (nga: Sadik), *Skifter* (nga: Shahin), *Luan* (nga: Arslan - Asllan apo Leon), *Dituri* (nga: Sofi) etj. Emrat e kësaj kategorie prej kohësh janë bërë të njohur e me përdorim të gjerë dhe si të tillë, ata konsiderohen emra vendas njëloj si gjithë emrat e tjerë vetjakë të burimit shqip.

Një burim tjetër, mjaft prodhues, ka qenë e është edhe krijimi i emrave të rinj, kryesisht nga sfera kulturele-letrare ose qytetare. Disa nga këta janë p.sh. emrat *Çlirim, Luftar, Edlirë, Ermirë, Artë, Bleritë, Boran, Lirak, Ermal, Dritan, Arjetë, Donjetë, Mirjetë, Rezar, Rrezar-gjendë, Majlindë, Gazmir, Valmir, Valjetë, Valdete, Linditë, Saimir* etj.

\*

Cilat sfera dhe njësi leksiko-gramatikore të shqipes paraqiten sot si më aktivet në formimin dhe pasurimin e mëtejshëm të emrave vetjakë?

24) Shih edhe P. Daka, *Për pasurimin e fondit kombëtar të antroponimeve (emrave vetjakë)*, «Mësuesi», 1969, 1 shkurt, f. 4.

25) Shih edhe A. Kostallari, *Njerëzit dhe emrat*, «Mësuesi», 1963, 31 maj, f. 4; P. Daka, *Përhapja e emrave vetjakë të fondit kombëtar — kërkesë e kohës «Zëri i Popullit»*, 1969, 23 prill, f. 2.

Sipas të dhënave faktike, që janë nxjerrë nga rregjistrat e gjen-djeve civile të pasqirimit të qyteteve Tiranë, Shkodër, Tropojë, Kukës, Krutjë, Durrës, Lezhë, Pukë, Burrel, Peshkopi, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë, Librazhd, Gramsh, Korçë, Skrapar, Gjirokastër, Kolonjë, Përmet, Tepelenë, Sarandë e Pogradec, dhe burimeve të tjera të dorës së dytë (lista të ndryshme me emra njerëzish, nga shtypi qendror e krahinor i këtyre dy-tre vjetve të fundit etj.), del se emrat vetjakë të burimit shqip vinë kryesisht nga këto sfera a njësi leksiko-grammatikore të shqipes: nga flora, nga fauna, nga emra konkretë e abstraktë të thjeshtë, të prejardhur a të përbërë, nga emra gjeografikë (toponimikë), etnonimikë, terminologjikë, nga substantivimi i mbiemrave, i foljeve, i ndajfoljeve etj.

Më poshtë po paraqesim, të ndarë sipas grupeve, emrat vetjakë të burimit shqip:

I. Emra vetjakë të ardhur drejtpërdrejtë nga leksiku konkret e abstrakt i sferave të ndryshme:

1. **Emra vetjakë nga flora**<sup>26</sup> (emra drurësh, shkurresh, bimësh, lulësh etj.) si p.sh. *Bajame-ja* (Ti. Du. Kol. Le. Sa. Skr. Vl. Gji. Elb. Ko.)<sup>27</sup>, *Borzilok-u* dhe *Borziloke-ja* (T. Be. Gji.), *Burbuqe-ja* (kudo). *Çetinë-a* (Shk.), *Dafinë-a* (kudo), *Fidan-i* dhe *Fidane-ja* (Ti. Per. Skr. Pesh.), *Karafil-i* dhe *Karafil-ja* (Ti. Per. Sa. Be. Skr. Pesh. Kol. Fi. Gji.), *Lule-ja* (kudo), *Manushaqe-ja* (kudo), *Mimozë-a* (kudo), *Mollë-a* (Ti. Shk. Be. Pesh. Skr.), *Nerenxë-a* (Ko. Fi. Pog.), *Rrap-i* (Ti. Gji. Be. Vl. Kol.), *Selvi-e* (Ti. Shk. Per. Elb. Tro. Sa. Ko. Du. Pu. Pog.), *Shegë-a* (kudo), *Trëndafil-i* dhe *Trëndafile-ja* (Ti. Sa. Per. Du. Ko. Kol. Kru. Vl. Gr. Skr. Fi. Gji. Lib. Pog.), *Trëndëlinë-a* (Ti. Sa. Për. Du. Ko. Kol. Kr. Fi. Pog. Gr. Pesh.), *Vjollcë-a* (kudo), *Zambak-u* (Ti. Per. Kol. Fi. Pesh.), *Zerde-li-a* (Per. Skr. Gji. Sa.) etj.

2. **Emra vetjakë nga fauna** (emra kafshësh, shpendësh, insektësh etj.) p.sh. *Bilbil-i* (me variantet dialektore: *Birbil* e *Bylbyl*) (Ti. Kol. Du. Kru. Gr. Vl. Fi. Gji. Shk. Pu. Te.), *Bukurezë-a* (Ti. Sa. Be.), *Dallandy-she-ja* (kudo), *Dash-i* dhe *Dashe-ja* (kudo), *Gjel-i* (edhe: *Gjelë-a*) (Shk. Tro. Kru.), *Flutur-a* (kudo), *Drenushë-a* (Ti.) *Gjeraqinë-a* (Ti. Sa. El.), *Kanarinë-a* (Ti. Per. Sa.), *Laureshë-a* (Ti. Pog. Sa. Ko. Te.), *Pëllumb-i* edhe *Pëllumbeshë-a* (kudo), *Petrit-i* (kudo), *Skifter-i* (Ti. Be.), *Shpend-i* (Ti. Shk. Kru. Tro. Pesh. Sa. Kol. Vl. Fi. Gji. Elb. Pog.), *Luan-i* (kudo), *Shqipe-ja* dhe *Shqiponjë-a* (kudo), *Thëllënxë-a* (edhe variantet: *Fëllënxë-a*, *Fllanzë-a*, *Thllanzë-a*) (Ti. Shk. Ko. Kol. Kru. Fi. Pu. Pog. Tro.), *Ujk-u* (edhe variantet: *Ujkan-i*, *Uk-a*, *Ukë-a* *Ulk-u*) (Shk. Tro. Ku. Pu.), *Zog-u* dhe *Zogë-a* (Shk. Ti. Pesh. Kru. Le.) etj.

26) Meqenëse është duke u punuar për një botim me emra vetjakë në formë fjalori, në këtë punim numri i emrave për çdo sferë do të jepet i kufizuar.

27) Për emrat që janë shumë të njohur, në kllapa, do të vëmë shënimin (*kudo*); për të tjerët, do të shënojmë, në kllapa, të shkurtuar emrin e qytetit, ku e kemi ndeshur. Lexuesit i bëhet e ditur se në këtë punim, autori, nuk i vuri vetes detyrën të japë edhe të dhëna statistikore, d.m.th. se sa herë ndeshet ky apo ai emër në këtë apo atë rreth. Gjithashtu do pasur parasysh se ky apo ai emër mund të ndeshet edhe në ndonjë rreth tjetër, veç atyre që shënohen në këtë punim. Për rrethet jepen këto shkurtime: *Be.* (Berat), *Bu.* (Burrel), *Du.* (Durrës), *Elb.* (Elbasan), *Gr.* (Gramsh), *Fi.* (Fier), *Gji.* (Gjirokastër), *Ko.* (Korçë), *Kol.* (Kolonjë), *Kru.* (Krutjë), *Ku.* (Kukës), *Pu.* (Pukë), *Li.* (Librazhd), *Le.* (Lezhë), *Per.* (Përmet), *Pesh.* (Peshkopi), *Sa.* (Sarandë), *Skr.* (Skrapar), *Shk.* (Shkodër), *Te.* (Tepelenë), *Ti.* (Tiranë), *Tro.* (Tropojë), *Vl.* (Vlorë), *Pog.* (Pogradec).

3. **Emra vetjakë nga emra konkretë të sferave të ndryshme** (emra sendesh, mjeshtresh, etj.) si p.sh. *Argjend-i* (Ti. Vl. Fi. Pog.), *Bjeshkë-a* (Shk. Kru. Pu. Tro.), *Borë-a* (Ti. Shk. Pu. Tro. Ku. Skr. Du.), *Bareshë-a* edhe: *Baresh-i* (Skr. Be. Kru.), *Bijë-a* (Pesh.), *Bir-i* (Sa.), *Çelik-u* edhe *Celnik-u* (Ti. Be. Skr. Pog. Gr. Kol. Kru. Vl. Fi.), *Çoban-i* (Ti. Vl. Fi. Te), *Çun-i* (Ti. Shk.), *Çupë-a* (Bu.), *Dritë-a* (kudo), *Dhuratë-a* (kudo), *Detar-i* edhe: *Detare-ja* (Ti. Be. Du.), *Granit-i* (Ti. Per. Ko. Sa. Be. Skr. Kol. Vl. Pog.), *Flamur-i* edhe: *Flamure-ja* (kudo), *Guri* (kudo, sidomos në Jugë), *Hënë-a* (edhe: *Hanë*) (kudo), *Kadife-ja* (Ti. Vl. Skr. Fi. Pu. Li. Du.), *Kalem-i* (Ti. Ko. Per. Du. Vl. Fi. Li. Pog. Gr.), *Stoli-a* (Ti. Sa. Kol. Vl. Skr. Gji. Pog. Gr.), *Sheqer-i* edhe: *Sheqere-ja* (Ti. Shk. Tro. Ku. Pu. Skr. Sa. Pesh. Ko. Per. Kol. Kru. Vl. Pog. Gji.), *Shkëndi-a* (Ti. Du. Shk. Be. Sa. Gr. Per. Skr. Kru. Vl. Fi. Pog.), *Partizan-i* dhe *Partizane-ja* (kudo), *Puntore-ja* (Sa. Be.), *Rudinë-a* edhe: *Rudin-i* (Ti. Be. Du. Le. Fi. Gji. Li. Pog. Gr.), *Vashë-a* (Ti. Pesh. Pu. Kru. Skr. Fi.), *Voglushe-ja* (Be. Skr. Gji. Du. Fi.), *Zojë-a* (edhe: *Zonjë-a*) (Ti. Kru. Shk. Fi. Be. Pesh. Per. Vl.), *Zonjushe-a* (Sa. Te. Vl. Fi.) etj. etj.

4. **Emra vetjakë nga emra gjeografikë** (nga toponomastika vendase: emra qytetesh, krahinash, fshatrat, malesh, lumenjsh etj.) p.sh. *Arbanë-a* (fshat) (Ti.), *Adriatik-u* edhe: *Adriatike-a* (det) (Ti. Du. Shk. Gr. Pu. Kol. Sa. Vl. Gji. Tro. Skr. Fi. Ko. El.), *Bushat-i* (fshat) (Ti. Ko.) *Çajup-i* (mal) (kudo, sidomos në Jug), *Delvinë-a* (qytet) (Skr.), *Drin-i* edhe: *Drinë-a* (Ti. Shk. Per. Fi. Gji. El. Pog. Ko. Du.), *Dukagjin-i* (krahinë) (Ti. Shk. Pu. Pesh. Vl.), *Gramoz-i* (mal) (Ti., sidomos në Jug), *Kastrat-i* (fshat) (Fi.), *Kelmend-i* edhe: *Kelmendë-a* (Ti. El. Shk. Be. Pog.), *Moravë-a* (mal) (Shk.), *Pezë-a* (fshat) (Ti.), *Sazan-i* (ishull) (Ti. Be. Per. Vl. Du. Kol. Sa. Kru. Skr.), *Shkëlzen-i* (mal) (Ti. Shk. Fi. Pu. Tro. Bu. Gji. Pog. Pesh. Du.), *Shqipëri-a* (Skr. Kol. Pog. Gr.), *Tomor-i* (mal), (kudo), *Valbonë-a* (fshat) (kudo), *Vjosë-a* (lum) (Ti. Be. Shk.) etj.

5. **Emra vetjakë me prejardhje banori (etnonimikë)** si: *Durrsake-ja* (Ti.), *Lumjane-ja* (Skr.), *Matjan-i* edhe: *Matjane-ja* (Ti. Gji. Sa. Vl.), *Shqiptare-ja* (Ti. Per.), *Vlonjate-ja* (Per.) etj.

6. **Emra vetjakë nga emra abstraktë të parmë** si. *Dëshirë-a* (kudo), *Jetë-a* (kudo), *Meritë-a* (kudo), *Shëndet-i* edhe: *Shëndete-ja* (Ti. Per. Kol. Ko. Vl. Skr.), *Shpresë-a* (kudo), *Virtut-i* edhe: *Virtute-ja* (Ti. Shk. Fi.), *Vlerë-a* (Ti. Shk.), *Vullnet-i* edhe: *Vullnete-ja* (kudo) etj.

7. **Emra vetjakë nga sfera e terminologjive dhe emërtimeve të ndryshme** si: *Arsim-i* (Ti. Be. Du.), *Asamble-ja* (Ti. Shk.), *Dialektikë-a* (Ti.), *Histori-a* (Skr. Kru.), *Ideal-i* edhe: *Ideale-ja* (Ti. Du. Per. Gr. Shk. Fi. Vl. Gji.), *Kongres-i* edhe: *Kongrese-ja* (Ti. Fi. Skr. Ku. Du. Tro. Vl.), *Shkencë-a* (Ti. Be. Skr. Kol. Du.), *Triumf-i* (Ti. Be. Vl. Tro.), *Vigjilencë-a* edhe: *Vigjilent-i* (Ti. Skr. Per. Vl. Ko.) etj. etj.

8. **Emra vetjakë nga emra kalendarikë** (emra ditësh, muajsh, stinësh) si: *Janare-ja* (Per. Fi.), *Mars-i* (Fi), *Merkur-i* (Ti. Gji. Vl. Sa.), *Nëntor-i* edhe: *Nëntore-ja* (Ti. Be. Per. Ko. Fi.), *Pranverë-a* (kudo), *Martë-a* (nga: e martë) (Shk. Ti. Kru. Le. Tro.) *Prendë-a* (nga: e prende -e premte) (Shk. Ti. Kru. Le. Tro.) *Shtatore-ja* (Pesh.), *Tetore-ja* (Ti.), *Verë-a* (kudo) etj.

9. **Emra vetjakë nga emra të prejardhur** (abstraktë e konkretë) *Adhurim-i* edhe: *Adhurime-ja* (Ti. Per. Gji. Pesh. Ko. Fi. Be.), *Afrim-i* edhe: *Afrime-ja* (Ti. Per. Shk. Fi. Ko. El. Pesh. Sa. Vl. Gji. Tro. Skr.), *Agim-i* edhe: *Agime-ja* (kudo), *Bashkim-i* edhe: *Bashkime-ja* (kudo),

*Bukuri-a* (kudo), *Çlirim-i* edhe : *Çlirime-ja* (kudo) *Dashuri-a* (kudo), *Dëfrim-i* edhe : *Dëfrime-ja* (Ti. Vl. Pesh. Shk. Du. Kol. Fi. El. Pog. Gr. Per.), *Dituri-a* (kudo), *Durim-i* edhe : *Durime-ja* (Ti. Per. Be. Sa. Du. Kru. Skr. Fi. Gji. El. Pog.), *Festim-i* edhe : *Festime-ja* (Ti. Shk. Be. Per. Sa. Kol. Vl. Gji. El. Pog. Pesh.), *Fitim-i* edhe : *Fitime-ja* (Ti. Per. Sa. Be. Skr. Du. Pesh. Kru. Vl. Fi. Gji. Pog.), *Fitore-ja* (kudo), *Fluturim-i* edhe : *Fluturime-ja* (Ti. Be. Le. Shk. Fi. Kol. Kru. Gji. Pesh. Gr. Pog.), *Gëzim-i* edhe : *Gëzime-ja* (kudo), *Guxim-i* edhe : *Guxime-ja* (Ti. Per. Skr. Sa. Gji. Pog.), *Kujtim-i* edhe : *Kujtime-ja* (kudo), *Lavdi-a* (kudo), *Liri-a* (kudo), *Lirim-i* edhe : *Lirime-ja* (Ti. Du. Tep. Shk. Fi. Pog. Gr. Tro. Per: Kol.), *Lavdërim-i* edhe : *Lavdërime-ja* (Ti. Sa. Tro. Du. Vl. Skr. Fi. Gi), *Luftim-i* edhe : *Luftime-ja* (Ti. Pesh. Du. Kol. Pog.), *Lulëzim-i* edhe : *Lulëzime-ja* (kudo), *Mirësi-a* (Ti. Be. Tro. Per. Du. Fi. Kol. Skr. Gji. El. Li. Pog.), *Nderim-i* edhe : *Nderime-ja* (Ti. Per. Be. Shk. Pesh. Sa. Ko. Du. Kol. Bu. Fi. Pu. Pog. Gr.), *Ndërtim-i* (Ti. Be. Skr. Per.), *Ndriçim-i* (Ti. Be. Shk. Pesh. Skr. Ko. Du. Gr. Kol. Fi. El. Pu. Pog.), *Pajtim-i* edhe *Pajtime-ja* (Ti. Shk. Per. Sa. Du. Kol. Vl. Fi. Gji. Pog. Ko.), *Përparim-i* edhe : *Përparime-ja* (kudo) *Shkëlqim-i* edhe : *Shkëlqime-ja* (kudo), *Shpëtim-i* edhe : *Shpëtime-ja*, (Ti. Ko. Per. Sa. Pesh. Kol. Vl. Fi. Tro. Gji. El. Pog. Pu.), *Trashëgim-i* edhe : *Trashëgime-ja* (Ti. Shk. Sa. Kol. Kru. Gji. Pog.), *Urim-i* edhe : *Urime-ja* (Ti. Per. Ko. Du. Fi. Gji. Vl. Pog.) etj. etj.

## 10. Emra vetjakë nga mbiemra të substantivuar

a) *Nga mbiemra të panyjshëm*: *Bestar-i* edhe : *Bestare-ja* (Ti. El. Be.), *Besnik-u* edhe : *Besnike-ja* (kudo), *Bujar-i* edhe : *Bujare-ja* (kudo), *Bukurosh-i* edhe : *Bukuroshe-ja* (kudo), *Fisnik-u* edhe : *Fisnike-ja* (Ti. Sa. Be. Shk. Kol. Kru. Gji. Pu. Pog.), *Çlirimtar-i* edhe : *Çlirimtare-ja* (Ti. etj.), *Gazmor-i* edhe : *Gazmore-ja* (Ti. Per. Be. Skr. Kol. Fi. Pog.), *Guximtar-i* edhe : *Guximtare-ja* (Ti. Per. Skr. Sa. Gji. Pog. Gr.), *Krenar-i* edhe : *Krenare-ja* (Ti. Be. Per. Sa. Du. Kol. Ko. Fi. Gji. Vl. Pog. Shk.), *Kreshnik-u* edhe : *Kreshnike-ja* (Ti. Shk. Vl. Du.), *Luftar-i* e *Luftëtar-i* edhe : *Luftare-ja*, *Luftëtare-ja*, (Ti. Shk. Per. Be. Fi. Pesh. Vl. Skr. Sa. Gji. Ko. Pog.), *Paqësor-i* edhe : *Paqësore-ja* (Ti. Be. Per. Kol. Fi. El. Pog. Gji.) etj. etj.

b) *nga mbiemra të nyjshëm me përngjitje të nyjës*, si *Edlirë-a*, (nga: e dli-rë) (Ti. Be. Shk. Fi. Gji. Pog. Gr. Du. Kru. Vl.), *Elirë-a* (nga: e lirë (Ti. Du.), *Emirë-a* (nga: e mirë) (Ti. Per. Sa. Be. Shk. Vl. Skr. Ko. Fi. El. Gr.), *Ejonë-a* (nga: e jonë) (Ti), *Ilir-i* (nga: i lirë) (kudo), *Imir-i* (nga: i mirë) (Ti. Vl.), *Idlir-i* (nga: i dli-rë) (Ti. Ko. Du.) etj.

c) *nga mbiemra të nyjshëm me rënje të nyjës*, si: *Artë-a* (nga: e artë) (Ti. Shk. Gji. Kol. Per. Be. Du. Sa. Kru. Skr. El. Pog. Gr.), *Blertë-a* (nga: e blertë) (Ti. Shk. Sa. Fi. El. Gji. Gr.), *Bute-ja* (nga: e butë) (Pesh. Shk. Tro. Ku. Kru), *Bardh-i* edhe *Bardhe-a* (nga: i, e bardhë) (kudo), *Marë-a* (nga: e m(b)arë) (Shk. Kru. La.), *Mir-i* dhe *Mirë-a* (nga: i, e mirë) (kudo), *Vogël-i* (nga: i vogël) (Shk. Kru. Le. Tre.) etj. etj.

11. **Emra vetjakë nga folje** si *Afron-i* (Ti. Gji. Sa.), *Agon-i* (Fi.) *Buron-i* (Ti. Be.), *Fillon-i* (Pog.), *Jeton-i* (Ti. Be.), *Lindë-a* (Ti. Pesh. Per.), *Lulëzon-i* (Ti.), *Ndrit-i* (Per. Kol.), *Rron-i* (Ti.), *Veron-i* (Ti.) *Veton-i* (Ti.) etj

12. **Emra vetjakë nga fjalë të përbëra ose të përngjiturasi** *Dashamir-i*

edhe: *Dashamirë-a* (kudo), *Fatbardh-i* edhe: *Fatbardhë-a* (kudo), *Fatlum-i* edhe: *Fatlume-ja* (Ti. Shk. Du.), *Fatmir-i* edhe: *Fatmirë-a* (kudo), *Gojart-i* edhe: *Gojartë-a* (Ti. Shk.) *Kushtrim-i* edhe: *Kushtrime-ja* (Ti. Skr. Du. Fi. Pu.), *Mirditë-a* edhe: *Mirdit-i* (Ti. Shk. Bë. Per. Gji. Fi. Pog.) (mund të jetë edhe nga toponimi Mirditë), *Ormir-i* edhe: *Ormirë-a* (Ti. Shk.) etj.<sup>28</sup>

II. Një grup më vete përbëjnë edhe emrat vetjakë të krijuar me anë të prapashtesave të ndryshme<sup>29</sup>. Kohët e fundit kjo mënyrë e formimit të emrave vetjakë me anë të prapashtesave po tregohet shumë prodhuese. Shumica e emrave me prapashtesa janë krijuar në bazë modelesh ekzistuese nga leksiku i shqipes. Po sjellim edhe këtu disa shëmbuj të emrave vetjakë të formuar sidomos me anë të prapashtesave:

**-ak** : *Lirak-u* (nga: i lirë), *Mirak-u* (nga: i mirë), *Verak-u* (nga: verë) etj.  
**-an** : *Bjeshkan-i* (nga: bjeshkë), *Bregan-i* (nga: breg), *Boran-i* (nga: borë), *Bardhan-i* (nga: bardh), *Çelikan-i* (nga: çelik), *Dëshiran-i* (nga: dëshirë), *Dritan-i* (nga: dritë), *Jetan-i* (nga: jetë), *Guran-i* (nga: guri), *Meritan-i* (nga: meritë), *Hekuran-i* (nga: hekur), *Mican-i* (nga: mic) *Pulan-i* (nga: pulë), *Shytan-i* (nga: shytë), *Shegan-i* (nga: shegë), *Ujkan-i* (nga: ujk) etj.

Disa nga këta emra kanë edhe korrespondueset për gjininë femrore, si *Bjeshkanë-a*, *Boranë-a*, *Guranë-a*, *Dritanë-a*, ose *Dritjanë-a*, *Meritanë-a*, *Sheganë-a*, *Ujkanë-a* etj.

**-ash** : *Borash-i* (nga: borë), *Dhurash-i* (nga: dhuratë), *Gurash-i* (nga: gur), *Lirash-i* (nga: lirë), *Lulash-i* (nga: lule), *Marash-i* (nga: marë), *Mirash-i* (nga: mirë) etj.  
**-ec** : *Bardhec-i* (nga: bardh), *Gurec-i* (nga: gur) etj.  
**-esh** : *Dardanesh-i* (nga: Dardan), *Flamuresh-i* (edhe: *Flamuresh-a*) (nga: flamur), *Lumturesh-i* (edhe: *Lumtureshë-a*) (nga: lumtur), *Sokolesh-i* (edhe: *Sokoleshë-a* nga: sokol) etj.  
**-i** : (vetëm emra femrorë): *Ermali-ja* (nga: Ermal), *Guri-ja* (nga: gur), *Hekuri-ja* (nga: hekur) *Luli-ja* (nga: lule), *Besi-ja* (nga: besë), *Fluturi-ja* (nga: flutur), *Lufti-ja* (nga: luftë), *Fitori-ja* (nga: fitore), *Ylberi-ja* (nga: ylber), *Ylli-ja* (nga: yll) etj.<sup>30</sup>  
**-im** : *Bardhim-i* (nga: bardh), *Flotim-i* (nga: flotë), *Flladim-i* (nga: fllad), *Gurim-i* (nga: gur), *Shpresim-i* (nga: shpresë) etj.  
**-inë** : (vetëm për emra femrorë): *Ajrinë-a* (nga: ajër), *Blerinë-a* (nga: blertë), *Borinë-a* (nga: borë), *Butinë-a* (nga: butë), *Gjelinë-a* (nga: gjelë), *Lulinë-a* (nga: lule), *Ylberinë-a* (nga: ylber), *Zerdelinë-a* (nga: zerdeli) etj.  
**-osh** : *Fatosh-i* (edhe: *Fatoshe-ja*) (nga: fat), *Gurosh-i* (nga: gur), *Gjelosh-i* (nga: gjel), *Jetosh-i* (nga: jetë), *Lavdosh-i* (nga: lavd), *Luftosh-i* (nga: luftë), *Marosh-i* (nga: mar), *Mirosh-i* (edhe: *Miroshe-ja*) (nga: mir) etj.

28) Si pasojë e një qëndrimi të ri e të drejtë ndaj emrave vetjakë, kohët e fundit, vihet re se shumë emra në qarkullim si Fidan, Karafil, Bijë, Bir, Çun, Çupë, Kadife, Sheqer e Sheqere, Ujk, Rron, Jeton, Vogël etj. nuk po përdoren më.

29) Shih edhe P. Daka, *Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*, «Stud. fil.», 3, 1968, f. 150-155.

30) Në disa vende këta emra paraqiten në trajtën e pashquar dhe me -e p.sh. *Gurie*, *Hekurie*, *Lulie*, *Besie*, *Fluturie*, etj.

- uk** : *Bardhuk-u* (nga: bardh), *Miruk-u* (nga: Miri), *Veruk-u* (nga: Verë ose Vero) etj
- ush** : *Bardhush-i* (edhe: *Bardhushe-ja*) (nga: Bardh,-e), *Drinush-i* (nga: Drin), *Fatush-i* (edhe: *Fatushe-ja*) (nga: fat), *Lalush-i* (nga: lalë), *Lulush-i* (edhe: *Lulushe-ja*) (nga: lule), *Mirush-i* (edhe: *Mirushe-ja*) (nga: Mir.-ë), *Nderush-i* (nga: nder), *Shegush-i* (edhe: *Shegushe-ja*) (nga: shegë), *Verush-i* (edhe: *Verushe-ja*) (nga: verë) etj.

Një pjesë e tyre si Mirak, Mirosh, Miruk, Ujkan etj. janë emra të vjetër, me origjinë popullore, të tjerë si Boran, Gurosh etj. janë, për analogji, formime të reja.

III. Një mënyrë tjetër e pasurimit të fondit të emrave vetjakë është edhe ajo me anë të fjalëve të përbëra ose të përngjitura. Kjo rrugë kohët e fundit është treguar shumë prodhuese. Zakonisht emrat vetjakë të përbërë ose të përngjitur formohen nga bashkimi i dy temave (fjalëve) të ndryshme: emër + emër, emër + mbiemër, emër + folje, mbiemër + emër, mbiemër + përemër, numëror + folje, etj. Është për t'u theksuar se mënyra e kompozimit a e përngjities së fjalëve tek emrat vetjakë nuk ndjek modelet a tipet e fjalëformimit (e kompozitive) në shqipe. Bashkimi, respektivisht përngjitja e dy fjalëve (temave) këtu bëhet, në shumicën e rasteve, në mënyrë mekanike. Kështu p.sh. me togje të lira fjalësh si: erë + e malit, valë + e detit, lule + e jetës, erë + e mirë etj. me të cilët janë krijuar emra shumë të bukur vetjakë si Ermal-i, Valdet-i, Luljetë-a, Ermirë-a etj. në gjuhë nuk mund të formohen kompozita, sepse bashkimi i tyre nuk krijon asnjë njësi të re leksiko-gramatikore që të shprehin një nocion të ri, siç e formojnë p.sh. togfjalëshat e lirë: breg + i detit < bregdet, fat + i bardhë < fatbardhë, zemër + e mirë < zemërmirë, shkozë + e bardhë < shkozbardhë etj. Formime të tilla, d.m.th. bashkime të lira fjalësh në antroponimi vërehen edhe ndër emrat vetjakë të mjaft vendeve të tjera<sup>31</sup>. Kjo mënyrë e formimit të emrave vetjakë me anë të bashkimit mekanik të një togfjalëshi të lirë, meriton një studim më vete më të thelluar.

Këtu poshtë po rreshtojmë një varg shëmbujsh të emrave vetjakë të përbërë ose të përngjitur, që janë ndeshur në rrethe të ndryshme të vendit tonë. Emra vetjakë të përbërë ose të përngjitur prej dy temash:

1) **emër + emër** : *Arjetë-a* (nga: ar + i jetës) (Pesh. Skr. Kru. Du. Kol. Fi.), *Erjetë-a* (nga: erë + e jetës) (Ti. Kru. Pog.), *Ermal-i* (nga: erë + e malit) (Ti. Sa. Kru. Du. Be.), *Ernatë-a* (nga: erë + e natës) (Sa.), *Ëndërrjetë-a* (nga: ëndërr + e jetës) (Gr. Ti.), *Lisimal-i* (nga: lis + i malit) (Ti.), *Luljetë-a* (nga: lule + e jetës) (Ti. Shk. Du. Gji. etj.), *Majmal-i* (nga: maje + mali) (Skr.), *Orjet-i* (edhe: *Orjetë-a*) (nga: orë (zanë) + e jetës) (Pog. Gr.), *Rezar-i* (nga: rreze + ari) (Ti. Ko.), *Rezeditë-a* (nga: rreze + e ditës) (Fi.), *Stinverë-a* (nga: stinë + e verës) (Skr.), *Valdet-i* (edhe: *Valdete-ja*) (nga: valë + e detit) (Ti. Be. Sa. Du. Shk. Vl. Gji. Pog. Gr. Tro.), *Valjetë-a* (nga: valë + e jetës) (Shk.) etj.

2) **emër + mbiemër** : *Besmir-i* (nga: besë + e mirë) (Fi.), *Dije-*

31) Ja disa shëmbuj, sipas A. Graur, *vep. e cit.* të disa emrave të përngjitur: *Kleopatra* nga gr. *kleos* «lavdi» + *pater* «baba», *Minella* nga gr. *mene* «guxim» + *laos* «popull»; *Rudolf* nga gjer. *hrod* «i përmendur» + *wulf* «ujk» *Frederik* nga gjer. *frid.* «paqë» + *rich* «i pasur» etj.

*mirë-a* (nga: dije + e mirë) (Be.), *Erjonë-a* (nga: erë + e jonë) (Du.), *Erlet-i* (edhe: *Erletë-a*) (nga: erë + e lehtë) (Ti. Be.), *Ermir-i* (edhe: *Ermirë-a*) (nga: erë + e mirë) (Ti. Ko. Be. Le. Du. Fi. Kol. Kru. Gji. Pog.) *Fatjon-i* (nga: fat + i jonë) (Ti. Pog. Ko. Du.), *Gazmir-i* (edhe: *Gazmirë-a*) (nga: gaz + i mirë) (Ti. Per. Du. Ko. Sa. Pesh. Tro. Be. Vl. Gji. El. Pog.), *Hanmirë-a* (nga: hanë + e mirë) (Tro.), *Hyllirie-a* (nga: yll + i ri) (Shk.), *Jetmir-i* (edhe: *Jetmirë-a*) (nga: jetë + e mirë) (Ti. Be. Shk. Fi. Pu. Pog.), *Jetlum-i* (nga: jetë + e lumtur) (El.), *Lajmirë-a* (nga: lajm + i mirë) (Be.), *Lalmir-i* (nga: lalë + i mirë) (Ti.), *Lavdimir-i* (edhe: *Lavdimirë-a*) (nga: lavdi + e mirë) (Per. Be. Fi. Pog. Ko.), *Luleartë-a* (nga: lule + e artë) (Pog.), *Lulmirë-a* (nga: lule + e mirë) (Pog.), *Punmirë-a* (nga: punë + e mirë) (Ti.), *Rrezeart-i* (edhe: *Rrezeartë-a*) (nga: rreze + e artë) (Ti. Be. Du. Pog.), *Symir-i* (nga: sy + i mirë) (Be.), *Valmir-i* (edhe: *Valmirë-a*) (nga: valë + e mirë) (Ti. Pog.), *Yllmirë-a* (nga: yll + i mirë) (Pog.) etj.

3) **emër + folje** : *Arlindë-a* (me inversion : lindi + ar) (Ti. Be. Du.), *Erlind-i* (edhe: *Erlindë-a*) (me inversion: lindi + (si) erë) (Ti.), *Fatlindë-a* (me inversion: lindi + (me) fat) (Ti.), *Lindihanë-a* (nga: lindi + hëna, si hëna) (Shk.). *Majlindë-a* (edhe: *Majlind-i*) (me inversion: lindi + (në) maj) (kudo) etj.

4) **mbiemër + emër** : *Bardhhanë-a* (nga: e bardhë + (si) hana?) (Ti.), *Emirjetë-a* (nga: e mirë + (si) jeta? apo me inversion: jetë + e mirë) (Ti. Pog. Du.), *Lumnan-i* (nga: nënë + e lumtur / e lumja + nëna (që të ka) (Ku.), *Mirzane-ja* (me inversion: za (zë) + i mirë) (Shk.), *Mirjetë-a* (me inversion: jetë + e mirë) (Ti. Shk. Du. Per. Kol. Tro.) etj.

5) **mbiemër + përemër** : *Emirjonë-a* (nga: e mirë + e jonë) (Skr.).

6) **numuror + folje** : *Iparlind-i* dhe *Parlind-i* (nga: lindi + i pari) (Vl. Ti.).

7) **folje + emër** : *Çeljetë-a* (nga: çel + jeta) (Ko.), *Donjetë-a* (nga: do + jetën) (Be. Ti.), *Jamarbër-i* (nga: jam + arbër) (Ti.), *Linditë-a* (nga: lind + dita), (Ti. Shk. Du. Ko. Gji. Tep. Skr. Fi. Be. El. etj.),

8) **folje + mbiemër** (ose **ndajfolje**) : *Jemir-i* (edhe: *Jemirë-a*) (nga: je + e mirë, ose mirë) (Ti. Fi.), *Jelirë-a* (nga: je + e lirë) (Fi.), *Lindmirë-a* (nga: lindi + e mirë, ose mirë) (Ti. Be.) etj.

9) **Veç këtyre, janë edhe disa emra nga lokucione si Miserdh-i** (edhe: *Miserdhe-ja*) (nga: mirë se erdhe) (Ti. Be. Vl. Shk.), *Mirvjen-i* (edhe: *Mirvjene-ja*) (nga: mirë (se) vjen) (Ti. Be. Kol.) *Saimir-i* (edhe: *Saimirë-a*) (nga: sa + i, e mirë) (Ti. Du. Shk. Ko. Per. Tro. Sa. Gji. El. Pog.), *Samirë-a* (edhe: *Samir-i*) (nga: sa mirë) (Ti. Shk. Du. Ko.).

\*

Nga të dhënat faktike që u sollën në këtë punim, lidhur me emrat vetjakë të burimit shqip, njësitë leksiko-gramatikore dhe rrugët e mjetet e pasurimit të fondit kombëtar të emrave vetjakë, del se:

1. Si burim për emra vetjakë të ardhur nga leksiku i shqipes kanë shërbyer e shërbejnë kryesisht fjalë nga sfera e faunës, e florës, e botës sendore, e toponomastikës, e emrave abstraktë të parmë, të prejar-dhur, të përbërë ose të përngjitur, si edhe fjalëve të kategorive të tjera leksiko-gramatikore (mbiemra, folje, togje fjalësh etj.). Numrin më të madh të emrave vetjakë të burimit shqip e përbëjnë emrat abstraktë,

veçanërisht emrat e formuar me prapashtesën *-im*, kurse emrat e sferave të tjera (e florës, sidomos emrat e luleve dhe të bimëve, e faunës dhe e botës sendore) si numër janë më të kufizuar. Kjo gjendje dikton nevojën e një shfrytëzimi më të madh të këtyre sferave.

2. Procesi i pasurimit të fondit të emrave vetjakë të burimit shqip, siç doli edhe gjatë artikullit, ka kaluar e po kalon kryesisht nëpërmjet katër rrugëve:

a) me kalim të drejtpërdrejtë të fjalëve të leksikut të përgjithshëm në emra vetjakë (khs. p.sh. emrat vetjakë: *Agim, Besë, Borë, Bujar, Dallandyshe, Dritë, Hënë, Flamur, Luan, Gëzim, Besnik, Pëllumb, Mimosë, Trëndëlinë, Vjollcë* etj. nga fjalë të leksikut të shqipes *agim, besë, borë, bujar, dallandyshe, dritë, hënë, flamur, luan, gëzim, besnik, pëllumb, mimosë, trëndëlinë, vjollcë* etj.).

b) me ndërrim gjinie ose trajte (kryesisht nga mashkullorja në femërore) khs. emrat vetjakë: *Borziloke-ja* (f) nga emri i përgjithshëm: *borzilok-u* (m), *Trëndafile-ja* (f) nga emri i përgjithshëm: *trëndafil-i* (m). *Diellë-a*\*(f) nga emri i përgjithshëm: *diell-i* (m), *Gjelë-a* (f) nga emri i përgjithshëm: *gjel-i* (m), *Adriatikë-a* (f) nga emri gjeografik: *Adriatik-u* (m) etj. Emrat emocionit me *-e* si *Agime-ja, Bashkime-ja, Blerime-ja, Lulëzime-ja, Gëzime-ja* etj. nga *Agim-i, Bashkim-i, Blerim-i, Lulëzim-i, Gëzim-i* etj. përbëjnë numrin më të madh të emrave vetjakë femërorë me ndërrim gjinie. Më pak ka emra me ndërrim gjinie nga femërorë në mashkullorë: *Prend-i* (m) nga *Prendë-a* (f.), *Drit-i* (m) nga *Dritë-a* (f), *Lul-i* (m) nga *Lule-ja* (f), *Rudin-i* (m) nga *Rudinë-a* (f) etj. Kalimi, respektivisht pasurimi i emrave vetjakë nga emrat femërorë në mashkullorë është një nga shtigjet që mund të shfrytëzohet më tepër në të ardhmen.

c) me formim të ri të prejardhur me anë të prapashtesave si: *Lirak-u* (nga: i lirë), *Dritan-i* dhe *Dritanë-a* (nga: dritë), *Lulash-i* (nga: lule), *Gurec-i* (nga: gur), *Flamuresh-i* (nga: flamur), *Lulë-a* (nga: lule), *Bardhim-i* (nga: bardh), *Butinë-a* (nga: butë), *Mirosh-i* dhe *Miroshe-ja* (nga: mirë), *Drinush-i* (nga: Drin-i) etj.

ç) me anë të përngjitjes ose të kompozimit të dy fjalëve në emra vetjakë si *Arjetë-a, Donjetë-a, Ermirë-a, Besmir-i, Erlet-i, Ermal-i, Majlindë-a, Rezar-i, Valmir-i* etj.

Shfrytëzimi dhe kombinimi me kriter i këtyre katër rrugëve, veçanërisht i rrugës së tretë dhe të katërt, hapin mundësi të mëdha për pasurimin e mëtejshëm të fondit kombëtar të emrave vetjakë.

3. Në bazën e shumicës së emrave vetjakë të burimit shqip qëndron motivi i dëshirës (deziderativi), ku me anë të emrit të zgjedhur shprehet dëshira që foshnja dhe jeta e saj të jetë e gëzuar, e lumtur, e lirë, e begatë, e ndritur, e shëndetshme, e pastër, e gjatë etj. Në këtë motiv gjërshetohet edhe figura e krahasimit. I porsalinduri, sipas emrit që zgjidhet për të, simbolikisht krahasohet me të bukurën, me të fortën, me të bardhën, me të butën, me të mirën, me të ëmblën, me krenaren, me të shpejtën etj. Kështu p.sh. disa emra si *Lule, Trëndafil, Mimosë, Vjollcë, Flutur, Hënë, Pranverë, Selvi* etj. kanë për motiv bazë figurën e së bukurës (i, e bukur si...); të tjerë emra si *Borë, Zëmbak, Pëllumb, Dritë* etj. krahasohen me diçka të bardhë (i, e bardhë si...); emrat

\*) Ka të ngjarë të mos jetë femërorizim i emrit *diell-i* por i ardhur nga fjala e *diellë* (sipas disa të folmeve të Veriut).

*Guri, Çelik, Hekur, Granit, Luan, Shqiponjë* etj. krahasohen me dicka të fortë (i. e. fortë si... ). Mjaft emra të tjerë simbolizojnë veti a karakteristika të ndryshme të popullit tonë, siç janë: forca, guximi, trimëria, besa, bujaria, besnikëria, mençuria, urtësia etj. që shprehen me anë të emrave vetjakë si *Besë, Bashkim, Besnik, Trim, Kreshnik, Luftëtar, Partizan, Çlirimtar, Fatos, Guximtar, Liri, Fitore* etj. Këto janë disa nga motivet kryesore pozitive të emrave vetjakë të shqipes.

4. Si pasojë e fitores së revolucionit popullor, e zhdukies së shfrytëzimit të njeriut prej njeriut, e likuidimit gradual të mbeturinave dhe të paragjyqimeve fetare të së kaluarës, e barazisë shoqërore midis burrit e gruas, e sigurisë për të sotmen dhe për të ardhmen, e ngrities ideologjike e kulturele të masave të gjera të popullit etj. një numër emrash vetjakë me përmbajtje negative apo fyese, poshtëruese dhe përbuzëse për dinjitetin e njeriut dhe që e kishin burimin nga motive të pesimizmit, të varfërisë e të mjerimit, të pasigurisë dhe të dëshpërimit etj., ose nga niveli i ulët ideologjik e kultural i trashëguar nga e kaluara — sot janë kufizuar në minimum dhe po shkohet drejt zhdukies së tyre. Nga emrat negativë, të trashëguar nga e kaluara, por që vazhdojnë të qarkullojnë ende aty-këtu në disa rrethe të vendit tonë, janë për t'u përmendur edhe këta: *Sose, Helme, Mifitime, Mbarime, Hiçe, Plotësim, Paqim, Mërzi, Ankim, Mërgim, Dëshprim, Fundim, Gazep e Gazep, Medet, Pseudhe* etj.

5. Veç atyre që sollëm më lart, një numër emrash vetjakë, si të periudhës së paraçlirimit, ashtu edhe të pasçlirimit janë marrë nga sfera e terminologjive të ndryshme të shkencës, teknikës, politikës, administratës etj. Megjithëse disa prej këtyre emrave si fjalë të leksikut terminologjik nuk kanë ndonjë kuptim të keq, si p.sh. *Arsim, Asamble, Artiler, Dialektikë, Dinamik, Demokrat, Ideal, Histori, Kimi, Agronom, Kongres-e, Kushtetutë, Muzikë, Divizion, Maiores, Revolucion, Shkencë, Ushtar, Vigjilencë, Sigurim, Zhuri* etj. mendojmë se për vetë karakterin e tyre specifik të ngushtë profesional e terminologjik, nuk janë të përshtatshëm dhe as të këshillueshëm për t'u përdorur si emra vetjakë. Po kjo vërejtje vlen edhe për disa emra të tjerë, ndonëse mjaft të rrallë, që janë zgjedhur e pranuar pa kriter dhe pa u thëlluar për rëndësinë që ka për njeriun emri që mba. Kështu p.sh. disa emra si *Autor, Modë, Praktikë, Inisiator, Preferim, Primar, Prodhim, Realizim, Sqarim, Shërbim, Rregjistrim* etj. duhen flakur. Gjithashtu edhe disa emra si *Vogëlushe, Vashë, Zonjushë* e ndonjë tjetër në qarkullim nuk këshillohen të përdoren, pasi emra të tillë për moshën e rritur dhe të pleqërisë, do të bëheshin qesharakë.

6. Dihet se fjalët, si njësi leksiko-gramatikore të gjuhës, kanë kuptime të ndryshme, ato shprehin, sipas përdorimit, nocione të caktuara për sende, fenomene, procese a cilësi të ndryshme të tyre etj. Të gjitha ato njësi leksiko-gramatikore të gjuhës (nëfshin këto fjalë të thjeshta, të prejardhura, të përbëra a togje fjalësh) kur kthehen në emra të përveçëm, si rregull e humbasin kuptimin leksikor, nuk shprehin më nocione, por shërbejnë, duke ruajtur funksionin nominativ, si fjalë për të emërtuar njerëzit (vendet, kafshët etj.). Ky ndryshim në përmbajtje nuk do të thotë se semantika e fjalës së përgjithshme, d.m.th. kuptimi leksikor i një fjale që zgjidhet për t'u përdorur si emër vetjak nuk luan më asnjë rol; përkundrazi, semantika e fjalës lot një rol aktiv në përdorimin e saj edhe si emër vetjak. Nga kuptimi leksikor

që ka fjala varet, në fund të fundit, edhe qëndrimi ynë për të pranuar ose jo këtë apo atë fjalë të zgjedhur si emër vetjak. Kjo do të thotë se jo çdo njësi leksiko-gramatikore e gjuhës mund të zgjidhet e të përdoret si emër vetjak dhe këtu duhet parë shkaku pse fondi i emrave vetjakë është shumë më i kufizuar se sa fondi leksikor i gjuhës. Kështu p.sh. disa fjalë shqipe si agim, pranverë, dritë, shkëlqim, jetë, helm, gazep, dëshprim etj. sot përdoren edhe si emra vetjakë. Megjithëse këto fjalë, të kthyer në emra të përveçëm, nuk shprehin nocione, pra nuk kanë as kuptim leksikor, ato për njeriun e kohës sonë nuk janë barabar të pranueshme. Kuptimi leksikor që kanë tri fjalët e fundit (helm, gazep, dëshprim) na shtyn jo vetëm të mos i pranojmë por edhe të luftojmë kundër përdorimit të tyre si emra vetjakë.

Pra, në zgjedhjen e një emri a të një fjale të përgjithshme për ta përdorur si emër vetjak, veç faktorëve të tjerë, duhet patur parasysh edhe ana kuptimore e fjalës.

Në fushën e studimit të emrave vetjakë, në përgjithësi, dhe të emrave vetjakë të burimit shqip, në veçanti, ka edhe njëra pjesë të tjera që mbeten për t'u trajtuar, siç janë llojet e motiveve, faktorët ekonomik-shoqërorë dhe kulturale të shtresave të ndryshme që kanë ndikuar në përdorimin e këtyre apo atyre emrave vetjakë, veçoritë krahinore ose krijimet analoge të emrave vetjake të shqipes të përjasur me ato të gjuhëve të tjera, patronimet etj.

\*

Lufta që po u bëhet sot anëmbanë në të gjithë vendin mbeturinave dhe njollave të së kaluarës, duke përfshirë këtu edhe një numër jo të paktë emra njerëzish, mbiemrash e emra vendesh me përmbajtje fetare ose që ruajnë ende gjallë gjurmët e shkelësve të ndryshëm e të klasave sunduese të së kaluarës, shtron, si kudo, që edhe në lëmin e onomastikës të ndërmerren një varg kërkimesh e studimesh në aspekte të ndryshme, të cilat, veç anës njohëse për të kaluarën, do të sillnin një kontribut të çmueshëm si në spastrimin e onomastikës shqiptare nga elementet e huaja, ashtu edhe në pasurimin dhe gjallërimin e saj me elemente të reja në mënyrë që t'u përgjigjen si duhet kërkesave të realitetit të sotëm historik.

### R é s u m é

#### OBSERVATIONS SUR LES NOMS PERSONNELS DERIVES DU LEXIQUE GENERAL DE L'ALBANAIS

Les immenses transformations socio-économiques, idéologiques et culturelles de ces vingt-cinq dernières années, transformations réalisées à la suite du triomphe de la révolution populaire et de l'approfondissement ultérieur de la révolution idéologique et culturelle, sont en train de renverser de plus en plus aussi plusieurs normes, coutumes, conceptions et autres survivances du passé, en leur substituant des normes, coutumes et nouvelles conceptions, socialistes, de notre époque. Dans le cadre de ces transformations sont en train d'entrer aussi les prénoms des hommes, comme une demande objective de développement de notre société nouvelle.

Toute époque ou tournant marquant — progressif ou régressif — dans l'histoire d'un peuple est associée par plusieurs transformations et l'apparition de nouveaux phénomènes tant dans le domaine du développement économique, politique et social, que dans celui idéologique et culturel. Ces transformations ont influé, dans des mesures et à des temps différents, aussi sur la sphère des anthroponymes (naissance, usage, diffusion ou bien disparition).

A la suite des dominations du territoire albanais pendant de longs siècles (Romains, Gréco-Byzantins, Slaves, Turcs, etc.) l'anthroponymie albanaise s'est vue surcharger de noms personnels d'origine étrangère, introduits et diffusés surtout sous l'influence des différentes confessions (chrétienne, musulmane, etc.) qu'ont apporté les conquérants. Outre les noms religieux, dans le répertoire des noms personnels de l'albanais figurent aussi plusieurs autres noms étrangers, laïques, d'origine italienne, allemande, française, russe, espagnole, etc., noms prétendument modernes, introduits sous l'influence des sphères culturelles (littérature artistique, cinéma, etc.) des pays respectifs. Ces derniers ont trouvé leur usage dans différentes couches de la population, sans distinction de religion. L'auteur fait noter qu'à côté des noms d'origine étrangère, existent aussi des noms laïques, de source aborigène. Ces derniers forment aussi l'objet de cet article.

La couche la plus ancienne des noms personnels aborigènes est formée, à l'avis de l'auteur, par les noms illyriens, qui ont ressuscité surtout durant ce siècle de l'anthroponymie et la toponymie illyrienne. Derrière ceux-ci viennent des noms personnels qui sont expliqués par la langue albanaise actuelle. La dépouille de quelques sources documentaires a permis à l'auteur de constater que, durant les siècles XII-XVII ont été en usage, à côté des noms d'origine étrangère, aussi des noms laïques de source albanaise, comme p. ex.: *Ulk* < *Ujk* «loup», *Bardh* «blanc», *Trim* «brave», *Buz* «lèvre», *Gur* «pierre», *Mal* «mont», *Diell* «soleil», *Kuqe* «rouge», *Rrap* «orme», etc., des noms dérivés: *Ujkan*, *Bardhec*, *Mirash*, *Lalush*, etc., et des noms composés: *Dashmir* «aimable», *Fatmir* «chanceux», *Lisimadh* «grand chêne», etc.

Le matériel des faits glané dans ces dernières années (utilisant à cet égard aussi les cadastres d'état civil des principales villes de l'Albanie) ainsi que d'autres sources (listes nominales, presse, etc.) ont permis de constater à l'auteur que le nombre des noms de source albanaise, depuis la Renaissance, et surtout depuis la libération du pays à nos jours, est allé toujours croissant. Cette croissance de l'usage des noms personnels de source albanaise est expliquée par l'aspiration des masses à se débarrasser des noms d'origine étrangère et confessionnelle et leur substituer de nouveaux noms illyriens et albanais.

L'auteur constate que l'enrichissement du fonds national des noms personnels de source albanaise a été réalisé en quatre directions:

I. Par le passage direct du lexique de l'albanais de plusieurs sphères de la langue à des noms personnels:

1. Noms personnels empruntés à la flore (noms de plantes, fleurs, bois, etc.): *Dafinë-a* «laurier», *Lule-ja* «fleur», *Manushaqe-ja* «viole», *Mimozë-a* «mimeuse», *Rrap-i* «orme», *Selvi-a* «cyprès», *Shegë-a* «grenadier», *Trëndafilë-ja* «rose», *Trëndëlinë-a* «fénugrec», etc.

2. Noms personnels empruntés à la faune (noms d'animaux, oiseaux, insectes, etc.): *Bukurezë-a* «coccinelle, bête à bon Dieu», *Bilbil-i* «rossignol», *Dash-i* «bélier», *Drenushë-a* «biche (femelle du cerf)», *Flutur-a* «papillon», *Pëllumb* «pigeon, bizet» et *Pëllumbesh-a* «colombe», *Laureshë-a* «alouette», *Petrit-i* «gerfaut», *Shpend-i* «grand oiseau», *Sokol-i* «milan», *Luan-i* «lion», *Shqiponjë-a* «aigle, f», *Ujk-u*, «loup», etc.

3. Noms personnels du lexique effectif des différentes sphères de la langue: *Argjend-i* «argent», *Borë-a* «neige», *Bjeshkë-a* «alpe», *Çelik-u* «acier», *Dhuratë-a* «don, étrenne», *Flamur-i* «drapeau», *Guri* «pierre», *Hënë-a* «lune», *Sheqer-i* «sucre», *Shkëndi-a* «étincelle», etc.

4. Noms personnels provenant des noms géographiques (toponymie aborigène: noms de villes, régions, villages, montagnes, fleuves et rivières, etc.): *Arbanë-a* (village), *Adriatik-u* (mer), *Bushat-i* (village) *Drin-i* (lum), *Dukagjin-i* (contrée), *Sazan* (flot), *Shkëlzen-i* (montagne), *Tomor-i* (montagne), *Valbonë-a* (village), *Vjosë-a* (fleuve), etc.

5. Noms personnels provenant d'ethnonymes: *Durrsake-ja* (de Durrës), *Lum-njane-ja* (de Lume), *Matjan-i* (de Mati), *Vlonjate-ja* (de Vlone), etc.

6. Noms personnels dérivant de noms abstraits; *Dëshirë-a* «désir», *Jetë-a* «vie», *Meritë-a* «mérite», *Shëndet-i* «santé», *Shpresë-a* «espérance», *Virtut-i* «vertu», *Vlerë-a* «valeur», *Vullnet-i* «volonté», etc.

7. Noms personnels provenant de noms concrets et abstraits dérivés: *Agim-i* «aube», *Bashkim-i* «union, ralliement», *Besë-a* «foi, parole donnée», *Bukuri-a* «beauté», *Çlirim* «libération», *Dashuri-a* «amour», *Dituri-a* «sagesse», *Festim-i* «fête, célébration», *Fitore-ja* «victoire», *Fluturim-i* «vol, envol», *Gëzim* «laetitia», *Guxim-i* «hardiesse», *Kujtim* «souvenir», *Lavdi-a* «gloire», *Liri-a* «liberté», *Mirësi-a* «bonté», *Lulëzim-i* «fleurissement», *Ndriçim-i*, «éclaircissement», *Përparim-i* «progrès», *Urim-i* «voeu», etc.

8. Noms personnels de la sphère des différentes terminologies: *Asamble-ja* «assemblée», *Républikë-a* «république», *Shkencë-a* «science», etc.

9. Noms personnels tirés du calendrier (jours, mois, saisons): *Janare-ja* «janvier», *Merkur-i* «mercredi», *Nëntor* «novembre», *Pranverë-a* «printemps», *Verë-a* «été», etc.

10. Noms personnels tirés d'adjectifs substantivés:

a) d'adjectifs inarticulés: *Bestar-i* «fidèle», *Besnik-u* «dévoué», *Bujar-i* «noble, large d'esprit», *Bukurosh-i* «beau», *Fisnik-u* «noble», *Gazmor-i* «joyeux», *Guximtar-i* «hardi», *Kreshnik-u* «preux», *Krenar* «fier», *Luftëtar* «combattant, guerrier», etc.

b) d'adjectifs articulés sous forme articulée: *Edlirë-a* (de: *e dlirë* «pure, propre»), *Elirë-a* (de: *e lirë* «libre»), *Emirë-a* (de: *e mirë* «bonne, affectueuse»), *Ejonë-a* (de: *e jonë* «nôtre»), *Ilir-i* (de: *i lirë* «libre»), *Imirë-i* (de: *i mirë* «bon, affectueux»), *Idlir-i* (de: *i dlirë* «pur, propre»), etc.;

c) d'adjectifs articulés sous forme inarticulée: *Artë-a* (de: *e artë* «dorée, d'or»), *Blerhtë-a* (de: *e blerhtë* «verte»), *Bute-ja* (de: *e butë* «douce»), *Bardh-i* (de: *i bardhë* «blanc»), *Marë-a* (de: *e m(b)arë* «ordonnée, féconde») *Mir-i* (de: *i mirë* «bon»), *Vogël-i* (de: *i vogël* «petit, petiot»), etc.

11. Noms personnels dérivant des verbes: *Afron-i* «rapproche», *Agon-i* «point (de poindre)», *Buron-i* «jaillit», *Jeton-i* «vit, existe», *Lindë-a* «(je suis) née», *Lulëzon-i* «fleurit», *Ndrit-i* «brille», etc.

12. Noms personnels provenant de mots composés: *Dashamir-i* «aimable, affectueux», *Fatbardh-i* «Fortunat, chanceux», *Fatmir-i* «chanceux», *Gojartë-a* «chrysostome, bouche d'or», *Kushtrim* «alarme, alerte», *Mirdit-i* «bonjour», *Ormir-i*, «à la bonne chance», etc.

II. Au moyen de suffixes formés dans le domaine des noms personnels et, surtout, au moyen de suffixes:

-ak (*Lirak-u*, *Mirak-u*, *Verak-u*, etc.),

- an (Bjeshkan-i, Bregan-i, Boran-i, Bardhan-i, Çelikan-i, Dëshiran-i; Dritan-i; Jetan-i, Guran-i, Meritan-i, Hekuran-i, Mican-i, Shegan-i, Ujkan-i, etc.),
- ash (Borash-i, Dhurash-i, Gurash-i, Lirash-i, Lulash-i, Marash-i, Mirash-i, etc.),
- ec (Bardhec-i, Gurec-i, etc.),
- esh (Dardaneshi-i, Flamuresh-i, Lumturesh-i, Sokolesh-i, Bilbileshe-i, etc.);
- i (seulement des noms féminins: Ermali-a, Guri-a, Besi-a, Lulia, Hekuri-a, Fluturi-a, Fitori-a, Ylberi-a, etc.):
- im (Bardhim-i, Flotim-i, Flladim-i, Gurim-i, Dhurim-i, etc.),
- inë (seulement des noms féminins: Ajrinë-a, Blerinë-a, Borinë-a, Butinë-a, Gjelinë-a, Lulinë-a, Ylberinë-a, etc.),
- osh (Fatosh-i, Gurosh-i, Gjelosh-i, Jetosh-i, Lavdosh-i, Mirosh-i, Marosh-i, Luftosh-i, etc.),
- uk (Bardhuk-u, Miruk-u, Veruk-u, etc.),
- ush (Bardhush-i, Drinush-i, Fatush-i, Lalush-i, Lulush-i, Mirush-i, Nderush-i, Shegush-i, Verush-i, etc.).

III. A l'aide du changement du genre des noms masculins au féminin et viceversa. La plupart des noms féminins dérivant des masculins — les noms de motions — sont formés à l'aide du suffixe *-e* (*Agime-ja, Gëzime-ja, Lulëzime-ja, Sheqere-ja, Bestare-ja, Gazmore-ja, Mirosh-ja*, etc. des noms respectifs *Agim-i, Gëzim-i, Lulëzim-i, Sheqer-i, Bestar-i, Gazmor-i, Mirosh-i*, etc.). Quelques noms féminins sont formés des masculins à l'aide de la désinence *-ë* (*Diellë-a, Gjellë-a, Mirë-a, Dritanë-a*, etc. de respectivement *diell-i, gjel-i, Mir-i, Dritan-i*, etc.). Moindre est le nombre des masculins provenant du féminin (*Lul-i, Drit-i, Baresh-i*, etc., provenant respectivement des féminins: *Lule-ja, Dritë-a, Bareshë-a*, etc.).

IV. Au moyen de la composition ou de l'agglutination souvent mécanique des deux thèmes (mots) dans le domaine des noms personnels:

1. **nom + nom**: *Arjetë-a* (de: ar + i jetës «or de la vie»), *Erjetë-a* (erë + e jetës «odeur de la vie»), *Ermal-i* (erë + e malit «vent de la montagne»), *Endërrjetë-a*, (endërr + e jetës «rêve de la vie»), *Luljetë-a* «fleur de la vie»), *Rezar* (reze + ari «rai d'or»), *Valdet-i* (valë + e detit «onde de la mer»), etc.

2. **nom + adjectif**: *Besmir-i* (besë + e mirë «bonne foi»), *Erlet-i* (erë + e lehtë «vent léger, zéphyre»), *Ermirë-a* (erë + e mirë «odeur propice»), *Gazmir-i* (gaz + i mirë «belle joie»), *Valmirë-a* (valë + e mirë «bonne vague»), etc.

3. **nom + verbe**: *Arlindë-a* (lindi + ar «or natif»), *Erlindë-a* (lindi + /si/ erë «née comme le vent»), *Majlindë-a*, (lindi + /në/ maj «née au mois de mai»), etc.

4. **adjectif + nom**: *Emirjetë-a* (jetë + e mirë «bonne la vie»), *Mirzane-ja* (za + i mirë «bonne la voix»), etc.

5. **adjectif + pronom**: *Emirjonë-a* (e mirë + e jonë «notre bonne»).

6. **numéral cardinal + verbe**: *Iparlind-i* (lindi + i pari «né le premier, aîné»).

7. **verbe + nom**: *Çeljetë-a* (çel + jetë «la vie s'épanouit»), *Donjetë-a* (don + jetën «il aime la vie»), *Linditë-a* (lindi + dita «le jour a point»), etc.

8. **verbe + adjectif**: *Jemir-i* et *Jemirë-a* (je + i, e mirë «tu es bon, ne»), *Jelirë-a* (je + e lirë «tu es libre»), *Lindmirë-a* (lindi + e mirë «née bonne»).

9. **de locutions**: *Miserdh-i* (mirë se erdhe «/sois/ le bienvenu»), *Mirvjen-i* (mirë /se/ vjen «bien arrivé»), *Saimir-i* et *Saimirë-a* (sa + i, e mirë «si bon, ne /que tu es/»), etc.

L'auteur ajoute que les noms personnels de source albanaise, qui sont encore en circulation, ne remontent pas à une et même période et non plus à une et

même source. Quelques-uns sont plus anciens, d'autres sont plus récents. Quelques-uns sont purement de source populaire, d'autres sont de source culturelle.

De source populaire, d'après l'auteur, sont plusieurs noms de la sphère de la flore et de la faune, moins du lexique abstrait: *Lule, Rrap, Shegë, Dash, Gjël, Shpend, Sokol, Thëllënxë, Ujk, Borë, Bjeshkë; Bute; Bardhe; Mir; Mirë;* etc. et les dérivés respectifs tels que *Lulash Mirash, Rrapush, Shegan, Gjëlosh, Ujkan,* etc.

Les autres noms sont des formations relativement plus récentes, issues sous l'influence des domaines culturel et littéraire. Quelques-uns de ces derniers tels que *Betim, Shpëtim, Shkëlqim, Agim, Lumturi, Besnik, Luan,* etc. résulteraient, selon l'auteur, du calque ou de la traduction des noms personnels des langue-étrangères. D'autres, tels que *Çlirim, Luftar, Edlirë, Ermirë, Artë, Bleritë, Boran, Lirak, Ermal, Dritan, Donjetë, Rezargjendë, Gazmir; Majlindë;* sont des créations aborigènes.

L'article est terminé par une brève conclusion sur les principales particularités des noms personnels en albanais et sur les tâches qui résultent pour l'avenir à traiter plus à fond l'anthroponymie albanaise.

